




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË PËR VITIN 2023

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Pagesa në vlerë 600,423€ ishte ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale për shpenzime që i takonin kategorisë së subvencioneve.
- B1 Vlera e prezantuar e pasurisë në PFV ishte mbivlerësuar për 16,781€ si rezultat i kategorizimit jo të drejtë të klasave të pasurive si dhe mos aplikimit të drejtë të zhvlerësimit.
- B2 MINT gjatë vitit 2023 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 133,636€ për 25 punonjës (të angazhuar me Marrëveshjen e Brukselit) të cilët nuk evidentohen për vijueshmërinë në punë dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në MINT.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MINT kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat që kërkojnë veprime të menjëhershme për shkak të ndikimit të tyre në PFV janë klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, menaxhimi dhe mirëmbajtja e regjistrave të pasurive, si dhe kompensimi i punonjësve.

Po ashtu, veprime duhet të ndërmerren edhe tek çështjet tjera të identifikuar në kategoritë përkatëse.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, dhe katër (4) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 shpenzimet duhet të realizohen dhe të evidentohen në kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i Udhëzimi Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Ministria gjatë vitit 2023 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 600,424€ në kategori ekonomike jo adekuate. Shpenzimet për nga natyra i takonin kategorisë subvencione dhe transfereve ndërsa ishin ekzekutuar nga kategoria investime kapitale. Shpenzimet kishin të bënin me subvencionimin e produkteve të qumështit.

Keqklasifikimi ishte ndikuar nga ekzekutimi pagesave përmes Thesarit për vendimet e Gjykatave. Thesari ishte drejtuar me kërkesën për propozimin e ekzekutimit të pagesës sipas kategorisë përkatëse ekonomike, mirëpo MINT kishte vendosur që pagesa të ekzekutohet nga kategoria e investimeve kapitale, në mënyrë që të mos cenojë mbështetjen për projektet tjera të planifikuara nga subvencionet.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kodet joadekuate të shpenzimeve kanë ndikuar në mbivlerësimin e investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e subvencioneve dhe transfereve duke ndikuar në paraqitjen jo të saktë dhe jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi A1

Ministria duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme nga zyrtarët përgjegjës në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B1 - Mbivlerësim i pasurisë kapitale****Gjetja**

Neni 6.1 i Rregullores MF-NR. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton që: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Për më tepër, neni 22 i kësaj rregullore përcakton metodën e zhvlerësimit të pasurive, normën si dhe llogaritjen bazuar në natyrën e pasurisë. Tutje, neni 12 i kësaj rregullore përcakton mënyrën e regjistrimit, kategorizimit dhe kalimit të pronësisë me rastin e blerjes apo ndërtimit të pasurisë përmes bashkëfinancimit.

Vlera e prezantuar e pasurisë në PFV ishte mbivlerësuar për 16,781€ (mbivlerësim 85,344€ dhe nënvlerësim 68,563€) si rezultat i kategorizimit jo të drejtë të klasave të pasurive si dhe mos aplikimit të drejtë të zhvlerësimit.

Çështjet që kanë ndikuar këtë gjendje janë shpalosur, si në vijim:

- Për projektin "Ndërtimi i mbikalimit për këmbësor dhe dy bus stacioneve të parku i biznesit në Drenas", gjashtë (6) transaksione në vlerë prej 113,869€, ishin klasifikuar si ndërtesa administrative, duke u zhvlerësuar për 40 vite, ndërsa sipas rregullores do të duhej të ishin klasifikuar si 'kapital tjetër' me jetëgjatësi 10 vite. Prej tyre, tre (3) transaksione në vlerë totale prej 93,774€ ishin ende të regjistruara si investime në vijim edhe pse pranimi teknik i projektit ishte bërë më 18.12.2019. Sipas kalkulimeve Vlera Neto në Libra (VNL) e këtyre pagesave do të duhej të ishte 76,815€, me ç'rast regjistrat ishin mbivlerësuar për 37,054€;
- Për projektin "Ndërtimi i kanalizimit të impiantit për ujërat e zeza në parkun e biznesit në Drenas", gjashtë (6) transaksione të testuara në vlerë totale prej 94,114€ ishin ende të regjistruara si investime në vijim duke mos u zhvlerësuar fare edhe pse pranimi teknik i projektit ishte bërë më 27.11.2018, që nëse do aplikoheshin zhvlerësimi, VNL do të duhej të ishte 46,273€. Në anën tjetër, për të njëjtin projekt, pesë (5) transaksione tjera në vlerë totale 175,354€, u është aplikuar zhvlerësimi nga momenti i pagesës (pa u bërë pranimi teknik). Si pasojë vlera neto e tyre në regjistrat ishte 18,102€ në vend që të ishte 86,216€. Duke iu referuar kërkesave të rregullores, dhe pranimi teknik, në total gjendja e regjistrat të pasurisë ishte nënvlerësuar për 20,273€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i klasifikimit të gabuar të këtyre pasurive me rastin e regjistrimit së tyre dhe në vazhdimësi kjo nuk ishte korrigjuar. Po ashtu, nga mungesa e koordinimit në mes të departamenteve përkatëse ku pas pranimi teknik të projekteve nuk ishte njoftuar zyrtarja e pasurisë për të kryer korrigjimet e nevojshme në sistem.

Ndikimi

Klasifikimi jo i duhur i pasurive në regjistrat kontabël, ka ndikuar në aplikimin e pasaktë të zhvlerësimit dhe ka shkaktuar mbivlerësim/nënvlerësim të vlerës së pasurisë në regjistrat kontabël. Në anën tjetër, mbajtja e projekteve të përfunduara në regjistrin e pasurisë si investime në vijim pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. E gjithë kjo ka rezultuar në pasqyrim jo të drejtë të gjendjes së tyre

në PFV.

Rekomandimi B1

Ministrja duhet të siguroj koordinim në mes të zyrtarëve përgjegjës dhe se aplikohet një analizë e mirëfilltë e regjistrat të pasurive për të siguruar se ato janë kategorizuar drejtë, në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta dhe raportim të drejtë në PFV. Po ashtu, të sigurojë që për projektet për të cilat janë bërë pranimet teknike, të bëhen rregullimet e nevojshme në regjistrat e pasurisë ashtu që vlera e tyre në regjistra të pasqyroj gjendjen e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Kompensim i punonjësve pa vijueshmëri në punë

Gjetja

Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve”, përcakton se “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik”.

Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ministria ishte e obliguar t' i sistemojë 25 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integritetit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Këta punonjës nuk kishin punuar asnjëherë për MTI që nga viti 2016 kur edhe janë nënshkruar aktemërimet e tyre. Rrjedhimisht, sipas konfirmimeve nga zyrtarët relevant, për të njëjtit nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë. Shpenzimi për vitin 2023 për këtë kategori ishte 133,636€.

Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse është raportuar në vazhdimësi nga Raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmarrë masa konkrete në sistemin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

Ndikimi

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte në vlerë 14,681,385€, prej tyre ishin shpenzuar 10,418.326€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me blerje për rezerva shtetërore si dhe shpenzimet për shërbime kontraktuese, për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, dreka zyrtare, shpenzimet e telefonit si dhe shpenzime tjera operative.

Çështja B3 - Ndarje e tenderëve për punë të njëjta

Gjetja Sipas nenin 5.3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, AK për të planifikuar aktivitetet e prokurimit duhet të mbledhë kërkesat, kur është e mundshme (të njëjta ose të ndërlidhura), për të fituar vlerën për parandë dhe për të reduktuar kostot e prokurimit.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se në njëmbëdhjetë (11) procedura të prokurimit në vlerë prej 59,867€, ministria kishte aplikuar ndarje të tenderëve për punë të natyrave të njëjta duke përdorur procedurën e kuotimit të çmimit, si dhe vlerën minimale.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos planifikimit të mirë të nevojave nga ana e njësisë kërkuese dhe shfaqjes së nevojave të domosdoshme të paparashikuara.

Ndikimi Mos aplikimi i një procedure të vetme të prokurimit për kërkesat e njëjta/ngjashme mund të rezultojë me një kosto më të lartë të shpenzimeve sesa çmimet e konkurrencës.

Rekomandimi B3 Ministria duhet të sigurojë që planifikimi i prokurimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet menaxherit të prokurimit me njësitë kërkuese për të diskutuar kërkesat e tyre me kohë për prokurim, në mënyrë që të ketë një planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 17,126, 926€, pasurive jokapitale është 86,522€, si dhe e stoqeve 3,358€.

Çështja B4 - Mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë

Gjetja

Neni 19.4 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare, përcakton se çdo fund vit duhet të bëhet inventarizimi, nga komisioni për inventarizim i cili është përgjegjës për: Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që janë në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore, verifikimi fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jo financiare, krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, dhe hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare.

Komisioni i inventarizimit kishte bërë inventarizimn e pasurisë për vitin 2023, ku kishte përpiluar Raportin gjithëpërfshirës të pasurisë jo financiare, mirëpo më tej nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël.

Gjithashtu vlen të theksohet, që informatat e vendosura në SIMFK me rastin e regjistrimit të pasurisë ndër vite, nuk posedonin mjaftueshëm detaje për të konfirmuar se për cilën pasuri bëhet fjalë.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive nga komisionet e inventarizimit të pasurive dhe mos kordinimit në mes të departamenteve përkatëse të MINT për evidentimin final të pasurisë së Ministrisë.

Ndikimi

Mungesa e inventarizimit të pasurive pamundëson krahasimin e rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive, prandaj vlera e pasurive në PFV mund të mos jetë e saktë.

Rekomandimi B4

Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka njohuritë dhe informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë, si dhe pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2023.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtar të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe një auditor. Për vitin 2023, kjo njësi kishte finalizuar pesë (5) auditime të rregullta të cilat i kishte në planin vjetor të punës. Periudha e mbuluar në raportet e NjAB përfshinte në dy raporte të auditimit periudhën paraprake, përderisa tek tre auditimet tjera përfshinte vitin aktual.

Çështja A2 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Neni 4 i UA MF-NR 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik përcakton se çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Komiteti i Auditimit në MINT ishte themeluar me datën 11.09.2019 për një periudhë 3 vjeçare. Edhe pse Komitetit të Auditimit i kishte skaduar mandati në fund vitit 2022, MINT nuk kishte ndërmarrë veprime për themelimin e Komitetit të ri të Auditimit.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së veprimeve për themelimin e komitetit të ri të auditimit ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore.

Ndikimi

Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit pamundëson mbikëqyrjen e punës së NJAB-së dhe rrjedhimisht sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontrolleve kyçe financiare dhe ndërlidhjes në përmirësimin e kontrolleve të brendshme përmes zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Rekomandimi A2

Ministrja duhet të sigurojë që në një afat sa më të shkurtë kohor të funksionalizoj Komitetin e Auditimit në MINT në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja efektive ndaj NjAB-së duket siguruar pavarësinë e kësaj njësie.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	39,827,685	41,799,741	33,912,794	26,818,339	14,012,257
Grante Qeveritare - Buxheti	31,056,603	33,013,659	27,434,081	24,000,365	13,685,355
Financimi përmes huamarrjes	6,671,082	6,671,082	6,478,712	2,817,974	326,901
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	2,100,000	2,100,000	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	15,000	0	0	0

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 1,972,056€. Ky ndryshim është rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ndarjes së fondeve të donatorëve.

Në vitin 2023 MINT kishte shpenzuar 33,916,665€ apo rreth 81% të buxhetit me një performancë të njëjtë në krahasim me vitin. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	39,827,685	41,799,741	33,912,794	26,215,968	14,012,257
Pagat dhe mëditjet	2,270,297	2,120,076	2,120,076	1,779,595	1,906,700
Mallrat dhe shërbimet	17,540,303	14,681,385	10,414,455	11,586,857	1,530,090
Komunalitë	158,280	158,280	98,041	42,437	38,919
Subvencionet dhe transferet	12,468,805	19,153,023	18,754,543	12,222,613	9,764,566
Investimet Kapitale	7,390,000	5,686,977	2,525,678	584,466	771,982

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 150,220€ dhe i njëjti ishte shpenzuar në nivel rreth 100%. Kjo lëvizje buxhetore ishte ndikuar nga harmonizimi i linjave buxhetore dhe tërheqja e mjeteve nga Thesari. Por krahasuar me vitin paraprak kishte rritje të shpenzimeve prej 19%;


Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte ulur për 2,858,918€. Kjo ulje si rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje dhe kursime nga linjat buxhetore;

Buxheti final për investime kapitale, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,703,023€, përkundër zvogëlimit, buxheti final ishte shpenzuar vetëm 44%. Projekti i CERP për e- inspektime ishte anuluar pas analizës së progresit në e-inspektime. Ky rezultat ishte ndikuar nga vonesat në rregullimin e bazës ligjore për ARBK, për arsye të vonesave të procedurave për hartimin e projektit dhe përgatitjes së specifikacionit teknik për renovimet e zyrave etj. Ndërsa, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje të shpenzimeve për 332% e cila ndikohet kryesisht nga rritja e shpenzimeve lidhur me programin për ndërtimin e zonave ekonomike nëpër Kosovë;

Buxheti final për subvencione dhe transfere, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 6,684,218€. Kjo rritje kishte ndodhur si rezultat i vendimeve të Qeverisë lidhur me ndarjen e mjeteve për Pakon e Ringjalljes Ekonomike.

Ndërsa, sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike për zbatimin e masës 2.1 "Subvencionimi i kredive investive" sipas vendimeve të Qeverisë ishin ndarë gjithsej 7,500,000€ gjatë vitit 2023 në programin Agjensia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërrmarjeve në Kosovë (KIESA). Të shpenzuara gjatë vitit ishin 6,684,217€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga MINT në 2023 ishin në vlerë prej 2,105,854€. Ato kanë të bëjnë me regjistrimin e pengut, pronësisë industriale, të hyrat nga licenca për shërbime profesionale, licenca për importimin e naftës, licencat për importimin e duhanit, të hyrat nga qiraja dhe të hyrat tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	2,847,456	2,847,456	2,105,854	2,609,786	2,483,017
Të hyrat jo tatimore	2,847,456	2,847,456	2,105,854	2,469,937	2,472,796
Të hyrat tjera	0	0		139,849	10,221

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të MINT ka rezultuar në shtatë (7) rekomandime. MINT kishte përgatitur me vonesë një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, tre (3) rekomandime janë zbatuar dhe katër (4) rekomandime nuk janë adresuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprime as gjatë këtij viti.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Ministrja duhet të sigurojë se aplikohet një analizë e mirëfilltë e regjistrat të pasurive për të siguruar se ato janë kategorizuar drejtë, në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta dhe raportim të drejtë në PFV. Po ashtu, të sigurojë që projektet e bashkëfinancimit për të cilat janë bërë pranimet teknike nga pala përfituese, të bëjnë bartjen e pronësisë përmes procedurave formale dhe në të njëjtën kohë të i largoj nga regjistrat e pasurisë së ministrisë.	Edhe gjatë 2023 kemi identifikuar raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Ministrja duhet të sigurojë një koordinim në mes të zyrtarëve përgjegjës për të siguruar se para çdo aktiviteti zbatohen procedurat e duhura drejt menaxhimit të aktiviteteve bazuar në të drejtat dhe përgjegjësitë kontraktuale.	Gjatë vitit aktual nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave tenderuese kryhen analiza të detajuara për projektet përkatëse në mënyrë që realizimi i tyre të mos pësojë ndryshime prej planit. Po ashtu, ministria duhet të sigurojë përmes stafit përkatës një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të papërfunduara. Më tutje të ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që punimet të realizohen sipas planit dinamik të kontraktuar.	Projektet kishin përfunduar gjatë vitit 2023 dhe ishte kryer pranimi teknik.	I zbatuar
5.	Çështjet e përbashkëta	Ministrja duhet të sigurojë që planifikimi i prokurimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet menaxherit të prokurimit me njësitë kërkuuese për të diskutuar kërkesat e tyre me kohë për prokurim, në mënyrë që të ketë një planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit.	Në gjatë vitit 2023 kemi identifikuar raste të reja të ndarjes së tenderëve në vlera të vogla.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë ka informata të plota për të gjithë pasuritë në përdorim dhe në pronësi të ministries, si dhe pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundojë para përgatitjes së PFV për vitin 2023.	Përkundër që MINT kishte ndërmarrë masa në implementimin e këtij rekomandimi ende nuk ishte implementuar në tërësi.	Nuk ka filluar zbatimi

7.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministrja duhet të siguroj se shfrytëzohen të gjithë mekanizmat ligjor në inkasimin e të arkëtueshmeve dhe në rast të mosrespektimit të kushteve të kontratës nga operatorët ekonomik, të shqyrtoj mundësinë e shkëputjes së kontratave.	Të gjitha obligimet e qirasë deri në vitin 2019, janë dërguar nga ministria në procedure përmbareme përmes Avokaturës Shtetërore, ndërsa për vitet 2020, 2021 dhe 2022 janë dërguar në procedure përmbareme gjatë vitit 2023. Të gjitha rastet e testuara janë fatura të cilat kanë tejkaluar afatin e përcaktuar me kontratë.	I zbatuar
----	-------------------------	--	--	-----------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Neslihane Mati, Udhëheqëse e ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Valbona Tolaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë/Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i
Trgovine /Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave
Financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për vitin 2023 (në
tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet, nuk kemi ndonjë koment për përmbajtjen e
Raportit; rekomandimet do të adresojmë me Planin e Implementimit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për
zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për
zbatimin e tyre.

Znj/ Rozeta Hajdari – Ministre

Rozeta Hajdari
Data: 13 Maj 2024 - Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1. "Furnizimi me bllomba (plumbçe) për nevojat e AMK-së" 2. Furnizim me bllomba (plumbçe) 3. "Furnizim me vula shtypëse dhe bllomba (plumbçe) për vitin 2024 për nevojat e AMK" 4. Furnizim me vula të sigurisë për nevojat e Inspektoratit të Tregut 5. "Shërbimet e transportit Prishtinë- Prizren dhe anasjelltas procesuar me datë 26.09.2023 7. "Shërbime të transportit në nevojat e Departamentit të Ndërmarrësisë" 8. "Sigurimi fizik për objektet e MINT-së"-2 muaj 9. Sigurimi i kamionit për nevojat e MINT; 10. Sigurimi i automjeteve të MINT 11. "Sigurimi fizik për objektet e MINT-së"- për 2 muaj shtesë
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.